



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:084087
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05771439

C.nr.1939/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditëses Lumnije Bllaca nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Malsore Halili, avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, me vlerë të kontestit 531.6 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Lumnije Bllaca nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 04.09.2021 – 21.11.2022, për 207 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t’ia paguaj paditëses shumën prej 346.00 euro dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për 168 ditë pune, duke llogaritur 70 % të vlerës së biletës së trafikut urban, t’ia paguaj paditëses shumën prej 117.6 euro, apo shumën e përgjithshme prej 531.6 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 14.02.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës paditëses në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 14.02.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, në vlerë prej 531.6 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është e punësuar te e paditura, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Ramiz Cernica” në Cernicë, në cilësinë e mësimitdhënëses dhe vazhdon të jetë në këtë pozitë të punës. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 22.01.2021 ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit

dhe udhëtimit për periudhën kohore 04.09.2021 – 21.11.2022. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 21.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura dhe për periudhën kohore 04.09.2021 – 21.11.2022 ka gjithsej 207 ditë të pranisë në punë, edhe atë 39 ditë në shkollën “Rexhep Elmazi” në Gjiilan dhe 168 ditë në shkollën “Ramiz Cernica” në Cernicë (fakt i vërtetuar edhe nga vërtetimet e lëshuara nga këto shkolla, me nr.prot.715/2023 të dt.14.12.2023 dhe nr.prot.198 të dt.18.12.2023); nuk është kontestuese se e njëjta ka vendbanimin në Gjiilan (fakt i vërtetuar edhe nga certifikata e vendbanimit nr.B 10488628 e dt.21.09.2023); e as nuk është kontestuese se bileta njëdrejtimëshe Gjiilan-Cernicë është 0.5 euro (fakt i vërtetuar nga vërtetimi i dt.03.06.2020 i lëshuar nga SHTU “Anamorava” dhe aneks-çmimorja).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 5 se “Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së caktuar, i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban; dhe paragrafi 7, se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 207 ditë në total, arrijnë vlerën prej 346.00 euro dhe për shpenzimet e udhëtimit për 168 ditë pune, për 70 % të çmimit për dy drejtim të biletës (1.00 euro) arrijnë vlerën prej 117.6 euro.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar të bazuar kërkesëpadinë paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi se shpenzimet e udhëtimit të paargumentuara nuk duhet të njihen, gjykata vlerëson se me gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, përmes provave konkrete është vërtetuar fakti i këtyre shpenzimeve, ndërsa të dy shpenzimet u kërkuar për periudhën kohore sa kanë qenë në fuqi të dy kontratat dhe nuk janë përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 14.02.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 04.09.2021.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së

shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1939/24, datë 23.05.2024

Gjyqtari,
Berat Spahiu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.